



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Planuar / Doretuar Prinjenol/Prudato Received/Delivery	02.03.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHUK	1123/2022		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.49/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtar dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.49/2022 të datës 24.01.2022, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi kundër organit të punësimit Komunës së Vitisë, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 01.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.49/2022 të datës 24.01.2022, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën të Vitisë, sipas Akt emërimit të datës 30.12.2011 në pozitën “Zyrtar për Rini dhe Sport”, me datën 13.04.2021, Kryetari i Komunës së Vitisë me Vendimin me numër 02-035/02-206 e ka caktuar ne kryerjen e detyrave jashtë orarit te punës në pozitën “Menaxher i Shtëpisë së Kulturës” deri në plotësimin e pozitës së lirë.

Ankuesi me datë 24.01.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 294/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendim ankimor që ti bëhet kompensimi i orëve shtesë për punët e kryer nga viti 2018, 2019, 2020 dhe 2021, gjithsejtë 254 orë e 30 min, nga fillimi i sistemit elektronik në SIMBNJ-së, kompensimin për punën e dyfishte me pagë të njëjtë, ridefinimin e kontratës se punës, si dhe kompensimin e orëve për pune jashtë orarit sipas Vendimit me numër protokolli 02-035/02-206 të datës 13.04.2021 të Kryetarit të Komunës së Vitisë .

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Vitisë, e cila më 18.02.2022, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike dhe për vendosje meritorie ka administruar këto prova: Ankesa e ankueses me numër të protokollit 294/2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër rendor A.nr.49/2022 me datë 24.01.2022; Shkresë emërim i datës 13.12.200; Akt emërim të datës 31.12.2011; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2019; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2018; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2017; Kërkesë e datës 30.11.2021; Pasqyrë e nxjerrë na SIMBNJ, Lista e nëpunësve prej 1/4 faqe; Akt emërim të datës 12.05.2021; Evidencë /Specifikacion i punës shtesë-jashtë orarit i datës 01.07.2021; Vendimin me numër protokollit 02-035/02-206 i datës 13.04.2021; Formular i datës 01.06.2021; Pasqyrë e nxjerrë na SIMBNJ-së prej 1/8 faqe; Përgjigje në ankesë e datës 18.02.2022, prej 1/3 faqe.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga ankuesi, ka konstatuar se ankesa e ankuesi *është e pa lejuar,*
sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar dëshmitë e ofruara dhe pretendimet e ankuesit ka konstatuar se ankuesi Akt emërimin në pozitën "Zyrtar për Rini dhe Sport" e ka nënshkruar me datë 30.12.2011, ndërsa me datë 13.04.2021, Kryetari i Komunës së Vitisë me Vendimin me numër 02-035/02-206 e ka caktuar në kryerjen e detyrave jashtë orarit të punës në pozitën "Menaxher i Shtëpisë së Kulturës" deri në plotësimin e pozitës së lire me arsyetimin se ankuesi i plotëson kushtet profesionale për të funksionalizuar kinemanë pas pranimit të teknologjisë moderne dixhitale nga Komisioni Evropian, kurse me datë 24.01.2022 ankuesi ka parashtruar ankesë me numër protokollit 294/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendim ankimor që ti bëhet kompensimi i orëve shtesë për punët e kryer nga viti 2018, 2019, 2020 dhe 2021, gjithsejtë 254 orë e 30 min, nga fillimi i sistemit elektronik në SIMBNJ-së, kompensimin për punën e dyfishtë me page të njëjtë, ridefinimin e kontratës së punës, si dhe kompensimin e orëve për punë jashtë orarit sipas Vendimit me numër protokollit 02-035/02-206 të datës 13.04.2021 të Kryetarit të Komunës së Vitisë .

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë, ka konstatuar se nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil, ndërsa Ligji Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 127 përcakton se: "1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ; 3. „Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacione, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike (këshillën juridike), afati i parashikuar nga paragrafi 1 i këtij neni është tre (3) muaj".

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke u bazuar në faktet e lartcekura ka konstatuar se parashtrimi i ankesës nga ankuesi me datë 24.01.2022 në Këshillin e Pavarur



Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafin 1 dhe 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: „Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ“ si dhe 3,, Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacione, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike (këshillën juridike), afati i parashkrimit nga paragrafi 1 i këtij neni është tre (3) muaj“. Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka vlerësuar se ankuesi nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e ankimit brenda afatit prej nëntëdhjetë (90) ditësh në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës respektivisht nga data 13.04.2021 kur ankuesi e ka pranuar Vendimin me numër protokolli 02-035/02-206 të Kryetarit të Komunës së Vitisë pa këshillë juridike, respektivisht ankuesi që nga viti 2011 nuk ka ndërmarr asnjë veprim ligjor gjegjësisht nuk ka ofruar asnjë dëshmi që ka parashtruar ankesë në kuadër të institucionit të punësimit apo në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, duke vepruar kështu në kundërshtim legjislacionin për shërbimin civil, Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative .

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkrësive të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.49/2022.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Zyrtare e Partë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesi;
- Kryetarit të Komunës së Vitisë;
- Menaxher të Personelit të Komunës së Vitisë, dhe
- Arkivit të KPMShCK-së.